

NGROHTORJA E QYTETIT SH.A. GJAKOVË

DICTRICT HEATING J.S.C. GJAKOVA

Adresa: "Behije Dashi" Rezinë, Gjakovë
Tel & Fax: (0390) 326 657
Mob: +383 (0) 46 127 066

NUI: 811326471
info@ngrohtorja.org
www.ngrohtorja.org

Datë : 30.12.2022

Nr: 920

RREGULLORE E PUNËS SË BORDIT TË DREJTORVE

Gjakovë

Tetor, 2021

Në mbështetje të nenit 34 paragrafit 1 të Ligjit nr.03/L 087 për Ndërmarrjet Publike lidhur me nenin 20 të Ligjit nr.04/L-111 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, dhe Ligjit nr. 06/L-016 Për Shoqëritë Tregtare, Bordi i Drejtorëve i Ndërmarrjes "Ngrohtorja e Qytetit" SH.A. Gjakovë, në mbledhjen e mbajtur më datën 27.10.2022, miratoi këtë:

RREGULLORE TË PUNËS SË BORDIT TË DREJTORËVE

I. Dispozitat e Përgjithshme

Neni 1

Qëllimi

Me këtë rregullore përcaktohet organizimi dhe mënyra e punës së Bordit të drejtorëve të Ndërmarrjes "Ngrohtorja e Qytetit" Sh.A. në tekstin në vijim "Ndërmarrja"

Neni 2

Organizimi dhe mënyra e punës së Bordit të Drejtorëve

1. Bordi i drejtorëve zgjidhet nga Komisioni Komunal i Aksionarëve të Komunës së Gjakovës dhe punën e vetë e bazon në dispozitat e Ligjit për ndërmarrjet publike, Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërmarrjet publike, Ligjin për shoqëritë tregtare, ligjet dhe aktet tjera nën ligjore të parapara për ndërmarrjet publike lokale.
2. Çështjet me rendësi nga fushëveprimi i Bordit, shqyrtohen në takimet e Bordit të Drejtorëve.
3. Secili anëtar i Bordit të drejtorëve duhet, që sipas përgjegjësisë së tij kolektive të:
 - a. Respektojë Statutin e ndërmarrjes publike lokale të shoqërisë dhe aktet tjera në pajtueshmëri me ligjin;
 - b. Përcaktojë, dhe rregullisht së paku çdo tre (3) muaj të rishikojë strategjinë e ndërmarrjes;
 - c. Përgatitë dhe miratojë strategjinë afatmesme-afatgjate, investimet dhe planet financiare të ndërmarrjes dhe brenda afatit relevant kohor të rishikojë atë, kurdo që është e nevojshme, së paku çdo tre muaj, të bëjë ndryshime të cilat mund të jenë të nevojshme për ndërmarrjen;
 - d. Përpilojë, miratojë, ndryshojë apo plotësojë Rregulloret dhe aktet tjera në pajtim me dispozitën e nenit 130, të Ligjit Nr-06/L-016 për shoqëritë tregtare dhe të nenit 20, të

Ligjit Nr-04/L-111, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.- 03/L-087, për ndërmarrjet publike;

- e. Nxjerr direktiva në bazë të planeve afatgjate strategjike për Kryeshefin Ekzekutiv, kurdo që është e nevojshme;
- f. Miratojë planin vjetor të biznesit dhe buxhetin vjetor të përgatitur nga Kryeshefi Ekzekutiv në bazë të planit të tillë afatgjatë;
- g. Emërojë, largojë apo zëvendësojë Kryeshefin Ekzekutiv, përcakton, me propozim të komisionit të auditimit kompensimin e tij ose saj, dhe siguron që procesi për përzgjedhjen e Kryeshefit Ekzekutiv, do të organizohet në mënyrë transparente dhe të arsyeshme, në këtë mënyrë t'i sigurojë ndërmarrjes disponueshmërinë dhe kompetenca adekuate;
- h. Përcaktojë transaksionet në bazë të të cilave Kryeshefi Ekzekutiv nuk do të ketë fuqinë të veprjës (dhe të obligojë ndërmarrjen) në mënyrë të pavarur kur duhet të kërkojë autorizim paraprak nga Bordi i Drejtorëve, apo nënshkrim të përbashkët të ndonjë zyrtari tjetër;
- i. Emërojë me propozim të Kryeshefit Ekzekutiv, dhe largojë apo zëvendësojë Zyrtarin Kryesor Financiar dhe të Thesarit dhe Sekretarin e Përgjithshëm, dhe përcakton në bazë të propozimit të Komisionit të Auditimit kompensimin e tyre për pagë;
- j. Përcaktojë me propozim të Kryeshefit Ekzekutiv, transaksionet financiare në bazë të të cilave Kryeshefi Ekzekutiv nuk do të ketë fuqinë të veprjës (dhe të obligojë ndërmarrjen) në mënyrë të pavarur, atëherë kur kërkohet autorizim paraprak nga Bordi i Drejtorëve;
- k. Kryejë mbikëqyrje të vazhdueshme dhe rigoroze mbi punën e biznesit të ndërmarrjes, mbi punën e Kryeshefit Ekzekutiv, Zyrtarit Kryesor Financiar dhe të Thesarit dhe Sekretarit të Përgjithshëm, mbi organizatën e brendshme të ndërmarrjes dhe mbi performancën e ndërmarrjes, dhe siguron, se linjat e raportimit të ndërmarrjes janë të organizuara për të lejuar performancën e duhur të një detyre të tillë të mbikëqyrëse; dhe mbi këto baza, të zbatojë këto detyra të besuara të zyrtarëve (në rastin e zyrtarit të auditimit të brendshëm, vetëm me propozim të komisionit të auditimit);
- l. Miratojë në fund të secilit vit të biznesit, pa kurrfarë vonese dhe në çfarëdo rasti, brenda nëntëdhjetë (90) ditëve, pas përfundimit të vitit financiar të ndërmarrjes:
 - Bilancin vjetor dhe pasqyrën e fitimit dhe humbjeve të ndërmarrjes, dhe çfarëdo pasqyre tjetër financiare që kërkohet me ligj.
 - Raportin vjetor të menaxhimit, rregulloret e biznesit, gjendjen financiare të ndërmarrjes do të duhej të përfshijë vështrimet, në atë mënyrë që performanca e ndërmarrjes të mund të barazohej me planet afatmesme apo afatgjata dhe të

paraqesë propozimin e saj për alokim, investim apo shpërndarje të fitimit vjetor, apo mbulimin e humbjeve.

4. Përgatitë deklaratën për aksionarët që, sipas njohurive më të mira të Bordit të drejtorëve, duke marrë parasysh raportin e Komisionit të auditimit dhe sipas hetimit të vetë të pavarur dhe të kujdesshëm dhe konsolidimit adekuat, dokumentet e lartpërmendura janë të vërteta, të drejta dhe të sakta, dhe ato nuk lënë pa përmendur asnjë informatë apo pasqyrë e që mos përfshirja e tyre do të konsiderohej si lajthitje, dhe ato t'i dorëzojë, së bashku me raportin nga Auditori i jashtëm në dokumentet e parashtruara tek aksionarët së paku tridhjetë (30) ditë para datës së mbledhjes së Komisionit komunal të Aksionareve.
5. Të sigurojë që sistemet adekuate të kontrollit të brendshëm, duke përfshirë kontrollin financiar dhe procedurat të jenë në vendin e duhur.
6. Të sigurojë se sistemet dhe procedurat adekuate janë në vendin e duhur për të garantuar se librat dhe regjistrat e ndërmarrjes, duke përfshirë regjistrat financiar, mbahen në pajtueshmëri me standardet e kontabilitetit dhe ligjeve në fuqi, dhe se draft raportet financiare vjetore janë të përgatitura si duhet.
7. Të sigurojë se auditimin i librave dhe regjistrave kryhet të paktën çdo vit nga auditori i jashtëm.
8. Të sigurojë se sistemet dhe procedurat adekuate janë vendosur, për të garantuar se ndërmarrja i respekton të gjitha ligjet e aplikueshme gjatë kryerjes së biznesit dhe detyrave.
9. Të identifikon, me kërkesë të Kryeshefit Ekzekutiv, indikatorët përkatës në mënyrë që të matet rregullisht performanca e ndërmarrjes.
10. Të sigurojë se biznesi i ndërmarrjes, nuk devijon nga qëllimi i deklaruar në statutin e ndërmarrjes.
11. Bordi i Drejtorëve mund, përveç kësaj, të nxjerr direktiva për Kryeshefin Ekzekutiv në organizimin e brendshëm të Shoqërisë dhe alokimin e fuqisë dhe autoritetin vendim-marrës së bashku me Zyrtarët dhe Menaxherët e ndërmarrjes dhe mund me propozim të Kryeshefit Ekzekutiv caktojë zyrtarë të tjerë (përveç KE, KZFTH, Sekretari të përgjithshëm dhe Zyrtari për Auditim të brendshëm), duke vendosur fuqitë, detyrat, dhe rregullat e tyre në lidhje me emërimin, kompensimin, largimin apo zëvendësimin e tyre.

Neni 3

Përbërja e Bordit të Drejtorëve

1. Bordi i drejtorëve përbehet nga pesë (5) drejtorë me të drejtë vote.
2. Katër (4) drejtorë zgjidhen në një mbledhje të aksionarëve në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare, dhe secili ka mandat prej tri (3) viteve. Komisioni Komunal i

Aksionarëve e përfaqëson komunën në këtë mbledhje dhe i ushtron të drejtat e votimit të komunës në përputhje me nenin 5.2 të ligjit për Ndërmarrje publike.

3. Drejtori tjetër është Kryeshefi ekzekutiv i Ndërmarrjes i cili zgjidhet nga Bordi i Drejtorëve të NP-së në përputhje me nenin 21 të ligji Për Ndërmarrje Publike.

Neni 4

Zgjedhja e Drejtorëve

1. Komision Komunal i Aksionarëve zgjedhë Bordin e drejtorëve në përputhje me dispozitat e Ligjit për Ndërmarrje publike të cilat rregullojnë zgjedhjen e drejtorëve të një shoqërie aksionare.
2. Gjatë zgjedhjes së drejtorëve, Komisioni Komunal i Aksionarëve duhet të sigurojnë që së paku dy (2) drejtorë të zgjedhur të jenë ekspert, ose së paku të kenë njohuri adekuate, të kontabilitetit, siç kërkohet me ligjin për ndërmarrje publike.
3. Bordi i drejtorëve menjëherë pas zgjedhjes, do të zgjedhë njërin nga anëtarët e tij për të shërbyer si kryesues. Përveç anëtarit i cili shërben si Kryeshef ekzekutiv i Ndërmarrjes, asnjë anëtar i Bordit të Drejtorëve nuk do të ketë kompetenca ekzekutive Kryeshefi Ekzekutive nuk mund të shërbejë si kryesues ose ushtrues detyre i kryesuesit të Bordit të Drejtorëve.
4. Kualifikimi i drejtorëve është i rregulluar me Ligjin nr.03/L-087, mbi Ndërmarrjet Publike.

Neni 5

Mbikëqyrja nga Bordi i Drejtorëve

1. Bordi i Drejtorëve të NP-së do të ushtrojë mbikëqyrje të vazhdueshme dhe rigoroze, në veçanti, të veprimtarisë së zyrtarëve të NP-së.
2. Nëse performanca e Ndërmarrjes devijon nga caqet e përcaktuara në Planin e Biznesit për vitin përkatës financiar, Bordi i Drejtorëve do të kërkojë një raport nga Kryeshefi Ekzekutive që shpjegon arsyet për performancën e dobët, dhe do të marrë të gjitha masat e duhura korrigjuese.
3. Sido që të jetë, nëse Ndërmarrja dështon në arritjen e caqeve të saj të performancës për dy vite financiare radhazi, Bordi i Drejtorëve është i detyruar të marrë parasysh shkarkimin dhe zëvendësimin e KE-së. Ky veprim mund të ndërmerret edhe në mungesë të provave bindëse të neglizhencës, përveç nëse Bordi i Drejtorëve konstaton se performanca e dobët ka ndodhur kryesisht për shkak të rrethanave ose ngjarjeve negative të paparashikueshme.
4. Bordi i Drejtorëve do t'ia raportojnë çdo vendim të marrë në bazë të këtij neni dhe arsyet për marrjen e këtij vendimi Kuvendit Komunal.

Neni 6

Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve

1. Bordi i Drejtorëve zgjedhë kryesuesin e tij me shumicë votash të të gjithë drejtorëve, dhe mund të shkarkojë dhe zëvendësojë kryesuesin në çdo kohë me shumicë votash.
2. Kryesuesi kryeson të gjitha mbledhjet e Bordit dhe kuvendet e aksionarëve dhe është përgjegjës përmbajtjen e të gjitha procesverbaleve nga të gjitha mbledhjet e Bordit. Nëse kryesuesi nuk është zgjedhur ose nuk është i pranishëm në mbledhjen e Bordit ose kuvendet e aksionarëve, atëherë një drejtor i zgjedhur me shumicë votash të drejtorëve të pranishëm shërben si kryesues i mbledhjes ose kuvendit në fjalë.
3. Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve nuk mund të jetë njëkohësisht edhe Drejtor Menaxhues.

Neni 7

Mbledhjet dhe njoftimet për mbledhjet

1. Kryesuesi i Bordit të drejtorëve thërret seancat, duke bërë të ditur rendin e ditës, së paku tri ditë para se të mbahet mbledhja, udhëheq ato dhe kujdeset për realizimin e konkluzave të miratuara. Në mungesë të kryesuesit të komisionit, seancat i thërret dhe i udhëheq anëtari tjetër i Bordit i autorizuar nga ai.
2. Bordi i Drejtorëve ka kuorum nëse janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve.
3. Vendimet e Bordit të Drejtorëve janë të vlefshëm nëse pro ose kundërt tyre votojnë shumica e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të pranishëm në mbledhje.
4. Në raste të numrit të barabartë të votave gjatë votimit pro ose kundërt një vendimi, vendimtare do të jetë vota shtesë e Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve.
5. Abstenimet regjistrohen me qëllim të themelimit të kuorumit, por nuk merren parasysh në rezultatet e votimit.
6. Në raste të emergjencës apo të gjendjes së jashtëzakonshme, njoftimi për mbledhjen duhet të përcillet me shkrim dhe të dërgohet me dorë, me faks apo emali së paku një ditë para mbledhjes.
7. Një drejtor është i detyruar që t'i kushtojë kohë të mjaftueshme ushtrimit të rregullt të detyrave të tij si drejtor, duke përfshirë kohën e pjesëmarrjes dhe përgatitjes për mbledhjet e Bordit.
8. Bordi i Drejtorëve mban një mbledhje të rregullt e cila njihet si mbledhje vjetore, menjëherë pas çdo kuvend vjetore të aksionarëve. Mbledhjet e rregullta mbahen në kohën dhe vendin të cilin e cakton Bordi në mbledhjen vjetore ose në një mbledhje tjetër të Bordit për të cilën janë njoftuar të gjithë drejtorët. Njoftimi mbi mbledhjet e rregullta nuk ka nevojë të dërgohet, përveç nëse këtë e kërkon Bordi i Drejtorëve.

9. Mban së paku dy (2) mbledhje të Bordit në vit për Shoqëritë Aksionare.
10. Mbledhjet e jashtëzakonshme të Bordit të Drejtorëve mund të organizohen në çdo kohë nga kryesuesi i Bordit, ose në rast se kryesuesi nuk e bën këtë, atëherë nga ndonjëri drejtor, përmes dërgimit të kërkesës me shkrim nga cilido drejtorit drejtuar kryesuesit. Personi i cili e thërret mbledhjen e jashtëzakonshme duhet të lajmërojë për vendin dhe kohën e mbledhjes.
11. Pjesëmarrja e një drejtori në cilëndo mbledhje përbën në vete heqjen dorë nga çdo njoftim i kërkuar për atë mbledhje, përveç kur drejtori merr pjesë në mbledhje me qëllim të vetëm për ta kundërshtuar diskutimin e pikave të mbledhjes, sepse mbledhja nuk është thirrur ose mbajtur me rregull dhe e deklaron në fillim të mbledhjes.

Neni 8

Udhëheqja e mbledhjeve dhe marrja e vendimeve

1. Mbledhjet e Bordit, sipas kësaj rregulloreje i udhëheq kryesuesi i Bordit, ose në mungesë të tij, njeri nga drejtorët të cilin e cakton Bordi i drejtorëve.
2. Para fillimit të mbledhjes, kryesuesi, vërteton numrin e anëtarëve, që janë të pranishëm dhe të atyre që mungojnë, dhe i njofton të pranishmit për pjesëmarrjen e shumicës së anëtarëve në mbledhje, ku mund të merren propozime meritore.
3. Kryesuesi i Bordit e hap mbledhjen, duke pyetur të pranishmit se a pajtohen me rendin e ditës të propozuar për atë mbledhje. Pas caktimit të rendit të ditës, fillon mbledhja sipas pikave të rendit të ditës.
4. Anëtari i Bordit të Drejtorëve mund të kërkojë shtimin e një pikë në rendin e ditës gjatë mbledhjes, nëse çështja që kërkohet të përfshihet në rend të ditës është çështje urgjente me rëndësi për ndërmarrjen.
5. Anëtarët e Bordit marrin pjesë në diskutim për të gjitha pikat e rendit të ditës, mund të kërkojë informacione shtesë, shpjegime, shtrojnë pyetje dhe kërkojnë përgjigje nga referuesit.
6. Shqyrtimi i pikave të rendit të ditës bëhet veç e veç, sipas rregullit, së pari në parim e pastaj në veçanti.
7. Mënyrën e udhëheqjes së shqyrtimit e propozon kryesuesi. Kryesuesi mund të propozojë, që koha e shqyrtimit të zgjatë jo më shumë se 3 deri në 5, minuta.
8. Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve duhet t'i përmbahet parimit të barabarësisë së anëtarëve të Bordit të Drejtorëve dhe duhet që të gjithëve t'iu mundësojë pjesëmarrje të barabartë në diskutim.
9. Askush nuk mund ta marrë fjalën në diskutim para se t'ia japë fjalën kryesuesi, t'i ndërhyjë në fjalë pjesëmarrësit në diskutim, apo në ndonjë mënyrë të pengojë punën e mbledhjes.

10. Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve ka të drejtë që anëtarit, i cili e pengon punën normale të mbledhjes, t'i japë vërejtje, t'ia marrë fjalën, e në rast të prishjes së rendit të ditës, ta largojë edhe nga mbledhja.
11. Diskutimi sipas pikave të veçanta të rendit të ditës, zgjatë sipas rregullës deri sa të mbarojnë diskutimet e të gjithë të paraqiturve.
12. Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve mbyll diskutimin dhe propozon, që të kalohet në propozimin e radhës si pas rendit të ditës.
13. Në bazë të propozimeve në material dhe mendimeve të shprehura gjatë diskutimeve, Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve formulon rezymetë apo konkluzionet dhe ato i paraqet për votim.
14. Gjatë marrjes së vendimeve, votimi bëhet me aklamacion (ngritje të dorës), përveç nëse është paraparë ndryshe me këtë Rregullore apo Statut, ndërsa rezultatet e votimit vërtetohen me numërim.
15. Propozimi konsiderohet i miratuar, nëse për atë deklarohen me shumë se gjysma e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve që janë të pranishëm.
16. Para votimit, çdo anëtar i Bordit të Drejtorëve, ka të drejtë ta veçojë votimin apo abstenimin dhe që kjo çështje të shënohet në procesverbal.
17. Bordi i Drejtorëve mund të deklarohet për formën e votimit, kur ka mundësi të zgjedhjes, për votim të hapur apo për votim të mbyllur.

Neni 9

Procesverbali nga mbledhja e Bordit të Drejtorëve

1. Procesverbali i secilës mbledhje të Bordit të Drejtorëve ose e cilit do komision, duhet të mbahet gjatë mbledhjes. Procesverbali formal me shkrim duhet të përgatitet jo më shumë se tri (3) ditë pas përfundimit të mbledhjes.
2. Procesverbali përfshin:
 - a. kohën dhe vendin e mbledhjes;
 - b. personat e pranishëm dhe agjendën e mbledhjes;
 - c. çështjet e hedhura në votim;
 - d. detajet e diskutimeve dhe arsyet e dhëna për çfarëdo vote negative ose abstenimi;
 - e. rezultatet e secilit votim, duke përfshirë emrin e secilit person që ka qenë i pranishëm dhe ka pasur të drejtë vote dhe një indikacion të asaj se si ky person ka votuar; dhe

- f. vendimet e miratuara në mbledhje.
3. Procesverbali formal me shkrim do të nënshkruhet nga drejtori që e ka kryesuar mbledhjen dhe nga personi që ka shërbyer si sekretar në mbledhje.

Neni 10

Raportet vjetore dhe tremujore

1. Brenda 30 ditëve pas përfundimit të çdo tremujori kalendarik, zyrtarët e NP-së do të përgatisin dhe dorëzojnë në Bordin e Drejtorëve një raport për tremujorin e sapo përfunduar ("tremujori përkatës") i cili përmban si vijon:
 - a. një pasqyrë të strukturës organizative të Ndërmarrjes duke përfshirë të gjitha ndryshimet e konsiderueshme që janë bërë gjatë tremujorit përkatës;
 - b. një shqyrtim të performancës afariste dhe financiare gjatë tremujorit përkatës;
 - c. një përmbledhje të të gjitha procedurave gjyqësore ose të arbitrazhit të pambaruar ose të kërcënuara, ose që mund të përfshijnë NP-në;
 - d. një përshkrim të procedurave gjyqësore ose të arbitrazhit të cila Ndërmarrja pritet t'i iniciojë gjatë tremujorit aktual;
 - e. transaksionet e konsiderueshme që përfshijnë Ndërmarrjen ose njësitë e saj ndihmëse; dhe
 - f. sugjerime dhe propozime për ndryshime të cila me arsye pritet që të rrisin performancën e Ndërmarrjes;
2. Brenda 30 ditëve pas pranimit të raportit tremujor, Bordi i Drejtorëve të Ndërmarrjes do ta shqyrtojë, ndryshojë dhe siç e sheh të arsyeshme të miratojë dhe dorëzojë, secilin raport të këtillë tremujor, sipas rastit, Ministrit dhe Qeverisë ose Komisionit/eve Komunal të Aksionarëve.
3. Brenda 45 ditëve pas përfundimit të çdo viti kalendarik, Zyrtarët e Ndërmarrjes, në përputhje me ligjin për ndërmarrje publike do të përgatisin dhe dorëzojnë Bordit të Drejtorëve, një raport vjetor për vitin kalendarik të sapo përfunduar, në të cilin përshkruhen veprimet e marra, rezultatet financiare të arritura si dhe efektshmëria e përgjithshme në realizimin e caqeve të vendosura në Planin e Biznesit.
4. Brenda 30 ditëve pas pranimit të raportit vjetor, Bordi i Drejtorëve të Ndërmarrjes do të shqyrtojë, ndryshojë dhe siç e sheh të arsyeshme të miratojë dhe dorëzojë, secilin raport të këtillë vjetor:
 - Njësisë për Politikën dhe Monitorimin e Ndërmarrjes e publikon atë në faqen e saj zyrtare në internet dhe sipas rastit, Komisionit Komunal të Aksionarëve. Bordi i NP-së po ashtu do të publikojë raportet vjetore në faqe e saj në internet me qasje publike e cila mbahet nga Ndërmarrja.

5. Bordi i Drejtorëve të Ndërmarrjes do t'u përgjigjet menjëherë dhe plotësisht të gjitha kërkesave për informata mbi Ndërmarrjen që parashtrohet nga personi ose organi i cili ushtron të drejtat e Aksionarit të Ndërmarrjes, përkatësisht Komisioni Komunal i Aksionarëve.

Neni 11

Emërimi i zyrtarëve

1. Zyrtarët e Ndërmarrjes emërohen nga Bordi i Drejtorëve. Zyrtarët shërbejnë për Bordin dhe Bordi mundet në çdo kohë dhe me shumicë votash ta ndërpresë kontratën e tyre me ose pa deklarin e arsyes. Pavarësisht nga sa u tha më sipër, Komisioni i Auditimit ka kompetencën ekskluzive për emërimin dhe shkarkimin e Zyrtarin për Auditim të Brendshëm, i cili shërben për Komisionin e Auditimit, i cili mundet, në çdo kohë dhe me shumicë votash, ta ndërpresë kontratën e këtij zyrtari me ose pa deklarin e arsyes.
2. Ndërmarrja sipas ligjit për Ndërmarrje publike ka këta katër zyrtarë:
 - a. Kryeshefin Ekzekutiv;
 - b. Zyrtarin Kryesor Financiar dhe të Thesarit;
 - c. Këshilltarin e Përgjithshëm/Sekretarit e Korporativ; dhe
 - d. Një Zyrtar për Auditim të Brendshëm;
3. Për përzgjedhjen së personave për emërim si zyrtarë të Ndërmarrjes, Bordi i Drejtorëve duhet të kryejë një procedurë të hapur, transparente dhe konkurruese e cila ka për qëllim që të gjitha emërimet të bëhet ekskluzivisht në bazë të meritës.
4. Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që të gjithë personat e emëruar zyrtarë të jenë person me integritet të njohur të cilët i plotësojnë kushtet e paraparë me Ligjin për ndërmarrjet publike që lidhet me:
 - a. Kualifikimin dhe plotësojnë kriteret e pavarësisë;
 - b. kanë përvojën e nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar për pozitën në fjalë, me kusht që Zyrtari Kryesor Financiar dhe i Thesarit të posedojë diplomë universitare dhe përvojë të konsiderueshme profesionale nga fusha e financave dhe/ose kontabilitetit;
 - c. Këshilltari i Përgjithshëm / Sekretari i Korporatës të posedojë diplomë universitare në ligj dhe përvojë të konsiderueshme profesionale nga fusha e qeverisjes korporative ose të drejtës së shoqërive tregtare; dhe
 - d. Zyrtari për Auditim të Brendshëm të jetë person Auditor i certifikuar;

Neni 12

Kompensimi i zyrtarëve të Ndërmarrjes

1. Kompensimi dhe përfitimet e zyrtarëve të Ndërmarrjes do të përcaktohen nga Bordi i Drejtorëve të NP-së në përputhje me deklaratën për politikën e kompensimit të Ndërmarrjes të përgatitur dhe të zbuluar nga Komisioni i Auditimit sipas nenit 20 pika 4 të ligjit për ndërmarrje publike.
2. Shkalla e kompensimit dhe përfitimet e zyrtarëve të Ndërmarrjes do të caktohet në një nivel i cili pritet të tërheqë aplikacione nga persona kompetent të cilët në masë të arsyeshme pritet se do ti ushtrojnë në mënyrë profesionale, të përgjegjshme dhe me orar të plotë detyrat e pozitës përkatëse. Nivele të ndryshme të kompensimit dhe përfitimeve mund të përcaktohen për secilën pozitë të zyrtarit brenda secilës NP të caktuar. Gjatë përcaktimit të nivelit të kompensimit dhe përfitimeve për një pozitë të zyrtarit të Ndërmarrjes, do të merren parasysh detyruar e pozitës përkatësi si dhe madhësia, natyra dhe kompleksiteti i veprimtarisë së Ndërmarrjes përkatëse.
3. Ndërmarrja është përgjegjësi për pagimin e kompensimit dhe sigurimin e përfitimeve tjera për zyrtarët e Ndërmarrjes.

Neni 13

Zbatimi i Detyrave (të besuara) Fiduciare të Zyrtarëve

1. Kurdo që ka informata të besueshme se cilido nga zyrtarët (duke përjashtuar Zyrtarin e Auditimit të Brendshëm, i cili i nënshtrohet ekskluzivisht autoritetit të Komisionit të Auditimit) ka vepruar në kundërshtim me detyrat e tyre fiduciare, Bordi i Drejtorëve do të zhvillojnë një hetim të hollësishëm dhe pa vonesë.
2. Nëse Bordi i Drejtorëve konstaton se një zyrtar ka bërë shkeljen e cilësdo nga detyrat e tij fiduciare, Bordi i Drejtorëve menjëherë:
 - a. Do të shkarkojë dhe zëvendësojë këtë zyrtar;
 - b. Ndërmarrja është e detyruar që menjëherë të kërkojë marrjen e masave ligjore kundër këtij zyrtari, kurdo që provat në dispozicion me arsye konsiderohet se janë të mjaftueshme për ngritjen e suksesshme të një padie për kompensimin e dëmeve që i janë shkaktuar NP-së nga shkelja, megjithatë;
 - c. Ndërmarrja nuk është e detyruar që të paraqesë padi kundër zyrtarit në fjalë nëse me arsye ka gjasa se shumica e kompensimit e cila mund të fitohet do të jetë më e ulët se shpenzimet të cilat me arsye pritet se do t'i ketë NP-ja gjatë zhvillimit të procedurës gjyqësore.

Neni 14

Vlerësimi i Efektshmërisë së Bordit të Drejtorëve

1. Bordi i Drejtorëve të Ndërmarrjes në bazë vjetore do të bëjë një vlerësim sistematik të performancës së vet. Kryesuesi është kryesisht përgjegjës për të siguruar kryerjen e rregullt dhe me kohë të vlerësimit. Vlerësimi do të analizojë performancën përgjithshme të bordit si dhe efektshmërinë dhe kontributin e anëtarëve individual të bordit. Vlerësimi po ashtu, ndër tjera, do të vlerësojë llojllojshmërinë e aftësive dhe përvojës si dhe kualifikimet tjera profesionale me qëllim të vlerësimit të Efektshmërisë së Bordit në tërësi dhe komisioneve të tij.
2. Gjatë kryerjes së këtij vlerësimi, bordi mund të kërkojë këshilla nga ekspertë të jashtëm dhe të pavarur si dhe nga përfaqësuesit e Aksionarit.
3. Bordi duhet të sigurojë që rezultatet e vlerësimit të realizuar sipas paragrafit 1 të këtij neni të përmbliidhen në një raport me shkrim i cili i dërgohet anëtarëve të Komisionit Komunal të Aksionarëve.
4. Njësia për Politikën dhe Monitorimin e Ndërmarrjes, në bazë vjetore, do të vlerësojë efektshmërinë e drejtorëve të Ndërmarrjes. Të gjithë zyrtarët dhe drejtorët e Ndërmarrjes përkatëse duhet të bashkëpunojnë plotësisht me Njësinë për Politikën dhe Monitorimin e Ndërmarrjes gjatë kryerjes së këtij vlerësimi.
5. Në përputhje me Ligjin për Prokurim Publik, Njësia për Monitorimin e Ndërmarrjes mund të angazhojë një ose më shumë këshilltarë profesional ose kompani të këshillimit për të ndihmuar në kryerjen e këtij vlerësimi. Njësia për Politikën dhe Monitorimin e Ndërmarrjes do të publikojë këtë vlerësim vjetor në faqen e saj në internet.

Neni 15

Shkarkimi i Bordit të Drejtorëve dhe Zyrtarëve

1. Nëse Ndërmarrja dështon në arritjen e caqeve të saj të performancës për dy vite financiare radhazi, personi përgjegjës për ushtrimin e të drejtave përkatëse të aksionarit është i detyruar që të marrë parasysh shkarkimin dhe zëvendësimin e Bordit të Drejtorëve ose shumicës së anëtarëve të tij.
2. Një veprim i këtillë mund të ndërmerret edhe në mungesë të provave bindëse të neglizhencës nga Bordi ose anëtarët përkatës të bordit, përveç nëse Aksionari konstaton se performanca e dobët ka ndodhur kryesisht për shkak të rrethanave ose ngjarjeve negative të paparashikueshme. Personat përgjegjës për ushtrimin e të drejtave përkatëse të Aksionarit do t'ia raportojnë çdo vendim të marrë në bazë të ligjit për ndërmarrje publike dhe arsyet për marrjen e këtij vendimi Kuvendit Komunal.
3. Drejtori i Bordit dhe zyrtarët e Ndërmarrjes "Ngrohtorja e Qyteti" SH.A – Gjakovë, mund të shkarkohen nga posti i tyre në çdo kohë kur konstatohet se këta zyrtarë i kanë

shkaktuar dëme materiale Ndërmarrjes, si edhe i kanë keqpërdor pozitat zyrtare apo është vepruar në kundërshtim me rregullat Statusore dhe Ligjore.

Neni 16

Vlerësimi i performancës nga ana e konsumatorit

1. Bordi i ndërmarrjes një herë në vit do të matë kënaqësinë e konsumatorëve në bazë të procedurave përkatëse përmes organizatave kredibile të pavarura.
2. Ky raport i dorëzohet Njesisë për Politikën dhe Monitorimin e Ndërmarrjes më së largu deri më 31 Mars për vitin paraprak, e cila e publikon atë në faqen e saj në internet dhe sipas rastit, Komisionit përkatës Komunal të Aksionarëve.

Neni 17

Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare


1. Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Rregullore bëhen në të njëjtën mënyrë sikurse në procedurën e aprovimit të saj komfor dispozitave të Ligjit Nr.03/ L-087, Mbi Ndërmarrjet Publike dhe Ligjit mbi Shoqëritë Tregtare në Kosovë.
2. Çështjet të cilat nuk janë definuar në këtë Rregullore, trajtohen drejtpërdrejtë sipas dispozitave ligjore të ligjit Për sigurinë dhe shëndetin në punë dhe akteve përcjellëse nënligjore.


Neni 18


Hyrja në Fuqi


Kjo Rregullore hynë në fuqi ditën e miratimit nga Bordi i Drejtorëve dhe fillon të zbatohet nga data: 01.01. 2023.

Anëtarët e Bordit të Drejtorëve të NP "Ngrohtorja e Qytetit" SHA në Gjakovë:



Kryesues,


Anëtarë/e,


Anëtarë/e,


Anëtarë/e,



Gjakovë, më 27.10.2022